

Gjykata e Qarkut të Mitrovicës
P. Nr. 70/07
8 Qershor, 2010

NË EMËR TË POPULLIT


GJYKATA E QARKUT TË MITROVICËS, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it, Hajnalka Veronika Karpati, kryesuese e trupit gjykues, si dhe gjyqtarët e EULEX-it, Charles L. Smith i III-të dhe Nikolai Entchev, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Noora Aarnio, Zyrtare Ligjor e EULEX-it si procesverbal mbajtëse, në rastin penal kundër;

Agron Dervishi, fillimisht i akuzuar me Vrasje të rëndë nga Neni 147 Paragrafi (1) Pika 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së) në lidhje me Nenin 23 të KPPK-së, Tentim Vrasje nga Neni 146 të KPPK-së në lidhje me Nenin 20 Paragrafi (1) dhe Nenin 23 të KPPK-së, si dhe pronësi e pa-autorizuar, kontroll, posedim ose përdorim i armëve, në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) të KPPK-së, në bazë të Aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut PP. Nr. 208/06, të datës 5 Mars 2007,

Pas mbajtjes së seancës publike lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të datës 25 Maj 2010, më 3 Qershor 2010, në prani të të akuzuarit Agron Dervishi, Avokatit të tij Mbrojtës, Zeqir Maxhuni, Prokurorit Publik të EULEX-it, Neeta Amin dhe palëve të dëmtuara Sadik Halili dhe Rrahim Halili, pasi që kishte pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të njëjtën ditë dhe pasi ajo (marrëveshje) është regjistruar në Gjykatë më 7 Qershor 2010 dhe pasi është mbajtur seanca publike lidhur me dënimin më 8 Qershor 2010, në prani të të akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës, Prokurorit Publik të EULEX-it dhe palës së dëmtuar Rrahim Halili, pas shqyrtimit të trupit gjykues dhe votimit të mbajtur më 8 Qershor 2010, në pajtim me Nenin 308A Pika 15 e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), shpallë publikisht dhe në prani të të akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës, Prokurorit Publik të EULEX-it dhe palës së dëmtuar Rrahim Halili, si në vijim këtë

AKTGJYKIM

I akuzuari **Agron Dervishi**, djali i Shaqir Dervishit dhe Mihane Dobranit, i lindur më 17 Dhjetor 1970 në fshatin Kastriot, Kosovar Shqiptar, me banim në fshatin Kastriot, i pa



martuar, pa fëmijë, me arsimim të mesëm shkollor, me profesion punëtor, i gjendjes mesatare ekonomike, nuk ka të dhëna të ketë qenë i dënuar më parë, në paraburgim që Nga 6 Shkurti 2007,

Duke u deklaruar fajtor për veprat penale të vrasjes në kundërshtim të Nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), si dhe pronësi e pa-autorizuar, kontroll, posedim ose përdorim i armëve në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) të KPPK-së në pajtim me Marrëveshjen e pranimit të fajësisë të datës 25 Maj 2010 dhe pasi që Gjykata e ka pranuar Marrëveshjen e pranimit të fajësisë me shkrim të datës 25 Maj 2010, më 3 Qershor 2010, të regjistruar në Gjykatë më 07 Qershor 2010.

DËNOHET

- me 9 (nëntë) vjet burgim për veprën penale të vrasjes
- me 2 (dy) vjet burgim për veprën penale të pronësisë së pa-autorizuar, kontroll, posedim ose përdorim të armëve.

Dënimi i përgjithshëm i grumbulluar është përcaktuar në 10 (dhjetë) vjet burgim, sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 e KPPK-së

Koha e kaluar në paraburgim që nga 6 Shkurti 2007 do të llogaritet në pajtim me Nenin 73 Paragrafi (1) të KPPK-së.

I akuzuari duhet të mbulojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të shpallet nga gjykata kur të dhënat të sigurohen në pajtim me Nenin 100 Paragrafi (2) të KPPK-së.

ARSYETIMI


A. HISTORIKU PROCEDURAL

Title: Agron Dervishi Judgment/Sentencing

*Translated by:
Ilir Venhari*

*Phone:
049 783685
044 294 217*

Page: 2 of 7



Prokuroria Publike e Qarkut të Mitrovicës, me aktakuzën PP. nr. 208/06 të datës 5 Mars 2007 ngarkoi Agron Dervishin me Vrasje të rëndë nga Neni 147 Paragrafi (1) Pika 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) në lidhje me Nenin 23 të KPPK-së, Tentim Vrasje nga Neni 146 të KPPK-së në lidhje me Nenin 20 Paragrafi (1) dhe Nenin 23 të KPPK-së dhe pronësi të pa-autorizuar, kontroll, posedim ose përdorim të armëve, në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) të KPPK-së.

Shqyrtimi kryesor gjyqësor ishte caktuar të fillojë më 02 Qershor dhe të vazhdojë më 03 dhe 8 Qershor 2010, por fillimi u shty për shkak të bisedimeve në zhvillim e sipër mbi deklarinimin e fajësisë mes palëve. Më 27 Maj 2010 Kryeprokurori i EULEX-it e informoi Gjykatën se një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë ishte arritur dhe nënshkruar më 25 Maj 2010. I akuzuari e kishte nënshkruar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë përpara se të paraqitej ajo (marrëveshje) në Gjykatë më 03 Qershor 2010.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

Sipas Nenit 23 Pika 1) i) të KPPK-së, gjykatat e qarkut janë kompetente për të dëgjuar rastet penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji lejon shpalljen e një dënimi penal të paktën pesë vjet. Në bazë të Nenit 27 Paragrafit (1) të KPPK-së, jurisdiksioni teritorial është në kuadër të duhur të gjykatës në qarkun ku një veprë penale dyshohet të jetë kryer.

Ashtu siç është përcaktuara më lart, akuza e Vrasjes së rëndë nga Neni 147 të KPPK-së lejon shpalljen e një dënimi minimal prej 10 vjet burgim. Përveç kësaj, aktakuza në këtë rast pretendon se i akuzuari e ka kryer veprën në fshatin Kastriot të komunës së Skenderajt..

Prandaj, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës është organi kompetent gjyqësor për të dëgjuar këtë procedurë penale.

Më 15 Shkurt 2010 Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it ia caktoi rastin gjyqtarëve të EULEX-it në bazë të Nenit 3.3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it.

Prandaj, gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës janë kompetente që të gjykojnë këtë veprë penale. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, si gjyqtare kryesuese e trupit gjykues, si dhe gjyqtarët e EULEX-it, Charles L. Smith i III-të dhe Nikolai Entchev, anëtarë të trupit gjykues. Të tre gjyqtarët janë të caktuar me punë në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës.

Asnjë palë nuk e kundërshtoi përbërjen e trupit gjykues.



C. MARRËVESHJA MBI PRANIMIN E FAJËSISË

Një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë i është paraqitur Gjykatës në një seancë publike në pajtim me Nenin 308A Pika 9 të KPPK-së më 03 Qershor 2010.


I akuzuari **Agron Dervishi** u deklarua fajtor për vrasje në shkelje të Nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Pronësi të pa-autorizuar, kontroll, posedim ose përdorim të armëve në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) të KPPK-së.

Marrëveshja me shkrim përmbante konstantime faktike si në vijim: Më 29 Qershor 2006, rreth orë 09:20 në rrugën afër shtëpisë së Agron Dervishit dhe Liridon Halilit, në fshatin Kastriot, komuna e Skenderajt, Agron Dervishi qëlloi me një pushkë sulmuese, AK-47 "kallashnikov", Liridon Halilin, i cili e drejtonte makinën e tij me tabela regjistrimi si në vijim: 491-KS-067. I pandehuri qëlloi me qëllim për të vrarë. Halili u plagos rëndë nga të shtënat me armë dhe më pas vdiq të njëjtën ditë në Qendrën e Emergjencës në Prishtinë.

Deri më 06.02.2007 Agron Dervishi e mbajti në posedim të tij një pushkë sulmuese AK-47 me numër serik 159762 në shtëpinë e tij në fshatin Kastriot, komuna e Skenderajt. Ai nuk kishte leje për këtë armë.

Palët e dëmtuara Sadik Halili, babai i viktimës, dhe Rrahim Halili, xhaxhai i viktimës, ishin të pranishëm në seancën publike më 03 Qershor 2010. Meqë i ati i viktimës gjendej jashtë vendit, Rrahim Halili u informua nga ana e prokurorit në lidhje me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Sadik Halili, babai i viktimës, në seancën më 3 Qershor 2010, deklaroi se familja nuk dëshiron të parashtojë kërkesë për dëmshpërblim. Ai ishte njoftuar lidhur me pranimin e fajësisë nëpërmjet vëllait të tij, Rrahim Halili. Në bazë të Nenit 308A Pikës 5 të KPPK-së, palës së dëmtuar duhet dhënë mundësia për të bërë deklaratë në gjykatë lidhur me kërkesën për dëmshpërblim. Në rastin aktual pala e dëmtuar, Sadik Halili - pasi iu dhanë udhëzimet përkatëse dhe shpjegimi se çfarë është kërkesa për dëmshpërblim - ka deklaruar në mënyrë të qartë para Gjykatës se ata nuk dëshirojnë të bëjnë një kërkesë të tillë. Atyre iu është dhënë mundësia të prezantojnë komentet e tyre mbi pranimin e fajësisë me ç'rast shprehën pakënaqësinë e tyre me dënimin e propozuar.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është pranuar nga Gjykata në ditën e seancës sipas Nenit 308/A, Pikës 10 dhe Pikës 15 të KPPK-së, pas marrjes në pyetje të të akuzuarit, Avokatëve Mbrojtës dhe Prokurorit Publik, Gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë i përmbushë kërkesat sipas Nenit 308A Pikës 12; I akuzuari e kuptoi natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ai vullnetarisht bëri pranimin e fajësisë pas konsultimeve të mjaftueshme me Avokatin e tij Mbrojtës dhe në asnjë mënyrë nuk ishte i shtrënguar e as i detyruar të pranojë fajësinë. Për më tepër pranimi i fajësisë mbështetet nga faktet dhe provat e çështjes, dëshmitë e dëshmitarëve, deklaratimet e të akuzuarit dhe



provave të dokumentuara në dosjen e lëndës. Prandaj, në bazë të artikullit 308A Pikës 15 të KPPK-së, Gjykata urdhëroi që Marrëveshja të paraqitet në Gjykatë dhe caktoi seancës për të shpallur dënimin më 8 Qershor 2010.

Marrëveshja është paraqitur në Gjykatë më 07 Qershor 2010.

D. DËNIMI

Më 8 Qershor 2010 trupi gjykues dëgjoi argumentet e të gjitha palëve në lidhje me dënimin. Palët paraqitën të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Pala e dëmtuar Rrahim Halili qëndroi pranë deklaratave të bëra nga vëllai i tij, Sadik Halili, më 03 Qershor 2010. Pas shqyrtimit, Trupi Gjykues shqiptoi dënimin sipas Nenit 308A Pika (15) të KPPK-së.


Kur të shqiptohet dënimi penal Gjykata duhet të ketë parasysh dy qëllime të përgjithshme të dënimin - që të shtypë aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke penguar të tjerët të kryejnë veprave të ngjashme penale, dhe me qëllim të veçantë - për të parandaluar kryesin e veprës penale të përsëris veprën. Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimin, Gjykata duhet të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas Nenit 64 Paragrafi (1) të KPK-së.

Në rastin e Agron Dervishit, Gjykata muar parasysh si faktorë rëndues moshën e re të viktimës që nuk ishte as 20 vjeç kur u vra dhe mënyrën se si i akuzuari e kreu veprën penale.

Gjykata e muar parasysh si rrethanë lehtësuese se i akuzuari nuk ka qenë i dënuar ndonjëherë më parë për ndonjë vepër penale, ai e pranoi veprën penale të vrasjes, shprehu pendim të sinqertë dhe mori përgjegjësinë për atë që ai kishte bërë. Një rrethanë tjetër lehtësuese është se ai ka qenë në paraburgimi për një periudhë jashtëzakonisht të gjatë kohore.

Për veprën penale të vrasjes në pajtim me Nenin 146 të KPK-së, ligji parasheh një dënim prej së paku 5 vjet. Duke marrë parasysh të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, trupi gjykues e shqipton dënimin prej 9 vjet burgim për këtë vepër penale.

Për veprën penale të pronësisë së pa-autorizuar, kontrollit, posedimit ose përdorimit të armëve në pajtim me Nenin 328 Paragrafi (2) të KPK-së, ligji parasheh një dënim me gjobë ose me burgim nga 1 deri në 8 vjet. Trupi gjykues shqipton dënimin prej 2 vjet burgim.



I akuzuari ka kryer dy vepra penale. Në pajtim me rregullat e llogaritjes së dënimit të përbërë nga dy pjesë, dënimi i përgjithshëm duhet të jetë më i lartë se çdo dënim individuale, por jo aq i lartë sa shumta e dënimeve të përcaktuara. Trupi gjykues e ka shqiptuar një dënim të përgjithshëm prej 10 vjet burgim, sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe (2) Pika 2) të KPPK-së.

I akuzuari Agron Dervishi ka qenë në paraburgim që nga 06/02/2007. Kjo periudhë kohore duhet llogaritur në dënimin e shqiptuar me burg sipas Nenit 73 Paragrafi (1) të KPPK-së.

E. LIGJI I APLIKUESHËM NË FUQI

Veprat penale janë kryer më 29 Qershor 2006. Në atë kohë Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), që hyri në fuqi më 06 Prill 2004, ishte ligji i aplikueshëm në fuqi. Në bazë të Nenit 2 Paragrafët (1) dhe (2) të KPPK-së, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të zbatohet kundër autorit të krimit nëse një ligj i ri nuk është më i favorshëm për të akuzuarin. I akuzuari pranoi fajësinë për veprat penale sipas KPPK-së. Megjithatë, disa ndryshime, duke përfshirë edhe institucionin e "Marrëveshjes së pranimit të fajit" u paraqitën në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës nga ana e Ligjit nr 03/L-003 që hyri në fuqi më 6 Janar 2009 kurse poashtu Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës u ndryshua me Ligjin Nr 03/L-002 që hyri në fuqi më 06 Janar 2009. Natyrisht, dispozitat në lidhje me një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë mund të aplikohen vetëm duke iu referuar ligjeve "të reja", Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së). Prandaj, Kodi Penal i Kosovës është më i favorshëm për të akuzuarin dhe Gjykata iu referua këtij ligji në Aktgjykim sa i përket dënimit.

F. SHPENZIMET

I akuzuari u shpall fajtor, prandaj, ai duhet të mbulojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) të KPPK-së, përveç shpenzimeve të përkthimit gjatë gjithë procedurës penale. Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të shpallet nga Gjykata kur të dhëna të tilla sigurohen në pajtim me Nenin 100 Paragrafi (2) të KPPK-së.


**Gjyqtarja Kryesuese
Hajnalka Veronika Karpati**

Title: Agron Dervishi Judgment/Sentencing

*Translated by:
Ilir Venhari*

*Phone:
049 783685
044 294 217*

Page: 6 of 7



Procesverbal mbajtëse
Noora Aarnio

Anëtarët e Trupit Gjykses: Charles L. Smith i III-të
Nikolay Entchev

Këshilla Juridike:

Ky Aktgjykim në lidhje me shqiptimin e dënimit bëhet i plotfuqishëm ditën kur shpallet meqe nuk bie nën Nenin 308A, Pikës 8.1 të KPPK-së.

